



BULETIN INFORMATIV

TETOR - DHJETOR 2025

Raporti Vjetor, ERRU raporton në Kuvend

Në 7 Tetor, Kryetarja e Entit Rregullator të Ujit, Znj. Gerta Lubonja raportoi mbi veprimtarinë e ERRU gjatë vitit 2024 në mbledhjen e përbashkët të Komisionit për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm me komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale. Raporti dëshmon një vit me rritje të ndjeshme të performancës dhe efikasitetit, me 17 shoqëri ujësjellës kanalizime të licencuara dhe mbulim të kostove operacionale në nivelin 109.8%. Reforma e rajonalizimit të sektori UK, në mbyllje të vitit të dytë të implementimit të saj, ka dhënë impakt pozitiv në drejtim të përmirësimit në përgjithësi të



situatës financiare të sektorit dhe rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar krahasuar me vitin paraardhës 2023. Në përfundim, komisionet miratuan Projektrezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së ERRU-së, bazuar në raportimin e bërë dhe diskutimet e zhvilluara në sallë. ERRU mbetet e përkushtuar ndaj shërbimeve të sigurta, të qëndrueshme dhe të përballueshme për qytetarët, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

- RAPORTI VJETOR
- PLANI I BIZNESIT
- VENDIMMARRJA E KKRR
- PJESËMARRJA NË AKTIVITETE
- NDËRGJEGJËSIMI I KONSUMATORËVE

Miratohet Modeli dhe Udhëzuesi i Planit të Biznesit 5-vjeçar

Në mbledhjen e datës 14 Nëntor, Komisioni Kombëtar Rregullator miratoi vendimin për Miratimin e Modelit dhe Udhëzuesit të Planit të Biznesit 5-vjeçar. Vendimi Nr. 539, datë 30.12.2021 i ERRU-së, në fuqi që prej 05.01.2022 ka paraqitur ndryshime thelbësore në metodologjinë e përcaktimit të tarifave për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Pjesë e këtyre ndryshimeve është edhe përfshirja e metodës së re “Çmim Tavan” e cila përdoret nga shoqëritë të cilat arrijnë të mbulojnë mbi 100% kosto O&M dhe më tej tentojnë të mbulojnë kostot Totale. Në këtë rast metodologjia e re e tarifave ka përcaktuar si detyruese aplikimin e shoqërive Ujësjellës Kanalizime për nivel të ri tarifor me Plan Biznesi 5-vjeçar, i cili duhet të jetë sipas një formati të unifikuar të miratuar nga ERRU. ERRU në bashkëpunim me AKUK kanë nënshkruar fillimisht marrëveshjen e bashkëpunimit e më pas në bashkëpunim me konsulencën e huaj kompaninë (SEURECA) të mbështetur nga Banka Botërore ka hartuar Modelin dhe Udhëzuesin e Planit të Biznesit 5-vjeçar konform kërkesave të përcaktuara në metodologjinë e vendosjes së tarifave. [Lexo dokumentin e plotë](#)



VENDIMMARRJA E KKRR

Në tre mujorin e fundit të vitit 2025, nga muaji tetor deri në muajin dhjetor, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU ka zhvilluar disa mbledhje, në të cilat ka miratuar vendime, midis të cilëve veçohen:

- ✓ Vendim për “Miratimin e Modelit dhe Udhëzuesit të Planit të Biznesit 5-vjeçar për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime”
- ✓ Vendim “Për miratimin e Bilancit të Ujit për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime për vitin 2024”
- ✓ Vendim “Për një shtesë në Rregulloren e Licencimit për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale”
- ✓ Vendim “Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator Nr.6, datë 22.02.2023 ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a’, i ndryshuar”
- ✓ Vendim “Për Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a”
- ✓ Vendim “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator Nr.2, datë 13.01.2025 “Për detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2025”
- ✓ Vendim “Për fillimin e procedurës për nivel të ri tarifor të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lezhë sh.a”

LICENCA



Në sektorin e ujit operojnë aktualisht 17 shoqëri ujësjetllës kanalizime, 14 prej të cilave të licencuara si shoqëri rajonale dhe tre shoqëri të tjera UK: Tiranë, Vorë, Kamëz. Situata mbetet e

njëjtë, pasi edhe përgjatë tre mujorit të fundit të vitit 2025, ERRU nuk ka patur asnjë vendimmarrje në lidhje me to. Sakaq, për Shoqërinë Rajonale UK Fier sh.a, me përfundimin e afatit të licencimit është rilicencuar me vendim KKRR. Po ashtu, ka patur ndryshime në Rregulloren e Licencimit si dhe në licencën e SHRUK Durrës, për shkak të ndryshimit të drejtuesit ligjor.

TARIFA



Në 3-mujorin e katërt të vitit 2025, e vetmja risi përse i takon Vendosijs së tarifave UK lidhet me Miratimin e Modelit dhe Udhëzuesit të Planit të

Biznesit 5-vjeçar për shoqëritë që aplikojnë për tarifa të reja pranë Entit Rregullator të Ujit. Një ndër vendimet e marra në fund të vitit është gjithashtu ai “Për fillimin e procedurës për nivel të ri tarifor për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës kanalizime Lezhë sh.a”. Aktualisht, numri i shoqërive rajonale që operojë me tarifa të reja që pas reformimit të sektorit të ujit është nëntë të tilla.

Asambleja e Përgjithshme e 36-të e WAREG & Forumi Evropian mbi Rregullimin e Shërbimeve të Ujit

Me një delegacion të udhëhequr nga kryetarja Znj. Gerta Lubonja, Enti Rregullator i Ujit mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të 36-të të WAREG, duke u bërë pjesë e diskutimeve mbi prioritetet strategjike të ujit dhe praktikat më të mira për menaxhimin dhe performancën e shërbimeve ujore. Në fjalën e saj, Lubonja paraqiti vizionin e Shqipërisë për një sektor uji të qëndrueshëm, duke nxjerrë në pah prioritetet kryesore: ofrimin e shërbimeve, forcimin e kapaciteteve dhe përafrimin me direktivat e BE-së. Ndërsa një ditë më 4 pas u zhvillua Forumi i 4-të Evropian mbi Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (#EFRWS25), ku u theksua: Rëndësia e financimit të



investimeve për qëndrueshmërinë e shërbimeve Benchmarkingsi dhe KPI për mbikëqyrje të bazuar në risk; Përgjegjësia e prodhuesve dhe menaxhimi i ujërave të ndotura (projekti WATERUN); Zgjidhje inovative nga projektet InnWater, RETOUCH NEXUS dhe GOVAQUA. Pjesëmarrja në këto aktivitete konfirmon rolin e ERRU-së në forcimin e shërbimeve ujore të ujit në Shqipëri.

Qëndrueshmëria e sektorit të ujit, ERRU në qendër të dialogut rajonal



Gjatë 11 – 13 Nëntor, ERRU mori pjesë në Konferencën dhe Ekspozitën e 13-të të Përbashkët Ballkanike, një prej eventeve më të rëndësishme në sektorin e ujit në rajon, ku përfaqësues institucionesh, operatorë të shërbimeve UK dhe partnerë ndërkombëtarë shkëmbyen praktikat më të mira për menaxhimin e ujit në kohë sfidash klimatike. Kryetarja e ERRU-së, Znj. Gerta Lubonja prezantoi vizionin për një sektor stabil dhe të orientuar drejt politikave me impakt afatgjatë. Ajo theksoi domosdoshmërinë e standardeve të harmonizuara rajonale dhe afrimit me direktivat e BE-së, si themel për një sektor të qëndrueshëm. Në sesionet dedikuar sfidave teknike, ERRU kontribuo edhe me dy prezantime mbi politikën e subvencionimit të ujit si shembull i qasjes rregullore dhe sociale në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe ‘Politikat rregullore e ndikimi në qëndrueshmërinë e shërbimeve UK’

Enti Rrregullator bashkëorganizon me WAREG seminarin e Programit “TAIEX” me vendet e zgjerimit të BE

Komisioni Evropian, në bashkëpunim me Shoqatën Evropiane të Rregullatorëve të Ujit (WAREG) dhe Entin Rregullator të Ujit (ERRU), organizuan më 23–24 tetor 2025 në Shkup, Maqedoninë e Veriut, seminarin e radhës të TAIEX me temë “Instrumentet teknike dhe ekonomike rregullore për reduktimin e humbjeve të ujit dhe përcaktimin e tarifave në vendet e zgjerimit të BE-së”. Si bashkëorganizator, Enti Rregullator i Ujit kontribuo në realizimin dhe koordinimin e aktivitetit, duke mbështetur aspektet organizative dhe bashkëpunimin ndërmjet rregullatorëve të vendeve pjesëmarrëse. Gjatë dy ditëve të seminarit u trajtuan tema kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit, si: Reduktimi i humbjeve të ujit përmes inovacionit dhe mjeteve të vlerësimit të investimeve; Caktimi i tarifave të ujërave të




ndotura në mënyrë të drejtë dhe transparente; Mbrojtja e konsumatorëve dhe menaxhimi efektiv i ankesave; Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Aseteve për garantimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të infrastrukturës. Ky aktivitet përbën një tjetër hap me rëndësi në angazhimin e ERRU për të promovuar praktika rregullore të avancuara, transparencë dhe eficiencë në sektorin e ujit, në përputhje me standardet më të mira evropiane.

ERRU në Kongresin e 6-të Global të Operatorëve të Ujit në Gjermani

Një përfaqësi nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU), kryesuar nga Z. Genci Gjeci, Anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator, mori pjesë në Kongresin e 6-të Global të Operatorëve të Ujit, ngjarjen më të rëndësishme ndërkombëtare të sistemit të OKB-së për sektorin ujësjellës-kanalizime

Organizuar nga UN-Habitat përmes Global Water Operators' Partnerships Alliance (GWOPA), kongresi mbledhi institucione, akademikë dhe ekspertë nga mbi 80 vende të botës për të ndarë përvoja, forcuar partneritete dhe për të avancuar bashkëpunimin global në sektorin e ujit.

Përmes përfaqësimit të saj aktiv, ERRU kontribuon në diskutimet për rritjen e cilësisë së shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore



dhe përparimin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) – veçanërisht garantimin e aksesit universal në ujë të pijshëm për të gjithë. Kjo pjesëmarrje nënvizon angazhimin e ERRU për të sjellë përvoja ndërkombëtare në shërbim të përmirësimit të sektorit të ujit në Shqipëri.

Rreziqet gjeologjike & hidrogjeologjike, Enti Rregullator i Ujit pjesë e diskutimit shkencor të Akademisë së Shkencave



Enti Rregullator i Ujit (ERRU) mori pjesë në datën 7 Nëntor në Konferencën Kombëtare të organizuar nga Akademia e Shkencave me temë “Rreziqet gjeologjike dhe hidrogjeologjike”. Diskutimet u përqendruan në sfidat dhe mekanizmat për forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit të ujit përballë rreziqeve natyrore. Në fjalën përshëndetëse, Kryetarja e ERRU-së, znj. Gerta Lubonja, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkencor për përballimin e rreziqeve hidrogjeologjike dhe garantimin e funksionimit të sektorit të ujit. Kjo konferencë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt bashkërendimit të dijeve shkencore dhe politikave rregulatore me synim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe operacionale të sektorit. ERRU u përfaqësua gjithashtu me një abstrakt shkencor me temë: “Rregullimi dhe qëndrueshmëria e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në kushtet e rreziqeve hidrogjeologjike”. Në 24 Dhjetor, ERRU u bë pjesë edhe e workshop-it shkencor të organizuar nga Akademia e Shkencave “Vlerësimi sasior dhe cilësor i burimeve ujore ndërkufitare të Shqipërisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut”.

Egjipt, Konferenca e 6-të Vjetore mbi Financimin dhe Investimet në Ujë



Në Konferencën e 6-të Vjetore mbi Financimin dhe Investimet në Ujë, e organizuar nga Union për Mesdheun (UfM) dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Egjipt, ekspertë dhe institucione nga e gjithë bota u mbledhën për të diskutuar prioritetet globale në financimin e ujit dhe rolin e bankave. Enti Rregullator i Ujit (ERRU) ishte pjesë aktive e kësaj konference me prezantimin “Situata Aktuale dhe Sfidat në Sektorin e Ujit në Shqipëri” nga Znj. Adriana Dema, Specialiste e Sektorit Teknik & Licencave, duke e vendosur vendin në dialogun ndërkombëtar mbi investimet në ujë. Konferenca përfshiu gjithashtu prezantime nga vende dhe iniciativa ndërkombëtare AIP Water Investment Summit dhe Blue Way Initiative, duke nxitur diskutime mbi projekte dhe aktivitete të ardhshme globale për financimin dhe menaxhimin e sektorit të ujit.



Enti Rregullator i Ujit
nis fushatën
informuese për të
ndihmuar
konsumatorët të
njohin **TE DREJTAT** dhe
DETYRIMET që
burojnë nga
KONTRATA E
SHËRBIMIT ujësjellës
Kanalizime.
Seria “A E DINI SE?”
sjell mesazhe praktike
për përdorim të
kujdesshëm, matje të
saktë dhe cilësi të
garantuar të ujit për të
gjithë.
Transparencë,
korrektësi dhe kujdes
për çdo pikë uji – ky
është thelbi i misionit
të ERRU



EVENTET E ARDHSHE NË FUSHËN E UJIT

23-25 Shkurt 2026 - Simpoziumi i 6-të Ndërkombëtar i Teknologjive të Ujit dhe Ujërave të Ndotura të IWA-së në Qytetërimet e Lashta Napoli, Itali

27 Shkurt 2026 - Konferenca e së Ardhmes së Ujit – Përgjigjet inovative për sfidat globale të ujit Budapest, Hungari

16-19 Mars 2026 - Konferenca e IWA-së e Reaktorëve të Biofilmit 2026 Orange Beach, Alabama, SHBA

4-7 Maj 2026 - IFAT Munich 2026 Munih, Gjermani



A E DINI SE ?





Çdo konsumator ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim për faturën e ujit brenda 30 ditëve nga marrja e saj



Operatori është i detyruar të regjistrojë çdo ankesë dhe të japë përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve nga regjistrimi i ankesës



Konsumatori ka të drejtë të kërkojë sqarim ose rishikim të faturës



Transparenca dhe komunikimi i hapur janë parime të garantuara nga ERRU

erru.al



A E DINI SE ?





Operatori ka detyrimin ligjor të kontrollojë rregullisht cilësinë e ujit të pijshëm.



Uji i pastër është e drejtë dhe përgjegjësi për të gjithë.



Nëse uji nuk plotëson standardet, furnizimi ndërpritet menjëherë deri në sigurimin e cilësisë.



Cilësia e ujit që përdorim është e mbrojtur me ligj.

ERRU dhe operatorët monitorojnë vazhdimisht standardet për sigurinë e konsumatorëve.

Uji i pastër – përgjegjësi e përbashkët!



A E DINI SE ?



Nëse mendoni se operatori ka shkelur detyrimet e kontratës apo nuk zbaton legjislacionin për shërbimet e ujit mund t'i drejtoheni ERRU me:



Ankesë me shkrim në adresën postare



Dorëzim i ankesës dorazi pranë ambienteve të ERRU



Në rrugë elektronike duke plotësuar në website erru.al: **FORMULARI I ANKESËS**

ERRU shqyrton ankesat në mënyrë të pavarur dhe të paanshme për të siguruar respektimin e të drejtave të konsumatorëve.



Për ujë të sigurt dhe shërbim të drejtë – informohuni, reagoni, raportoni!



A E DINI SE ?





Çdo ndërhyrje ose lidhje e paligjshme në sistemin e furnizimit me ujë apo në rrjetin e kanalizimeve përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet



Ndërhyrjet në rrjetin e ujësjellësit apo kanalizimeve janë të ndaluara dhe dëmtojnë furnizimin me ujë për të gjithë



Sipas kontratës së Shërbimit, konsumatori që kryen lidhje të paautorizuara përballet me gjoba dhe ndërprerje të furnizimit



Uji është i përbashkët – ta mbrojmë me përgjegjësi!



A E DINI SE ?





Konsumi i ujit llogaritet vetëm në bazë të matjes reale nga ujëmatësi



Operatori është përgjegjës për instalimin, kontrollin dhe zëvendësimin e tij sipas standardeve



Ndërhyrjet në ujëmatës janë të ndaluara dhe të dënueshme



Çdo ndërhyrje apo lidhje e paligjshme dëmton jo vetëm sistemin, por edhe komunitetin.

Kujdesuni për **UJËMATËSIN** – ai mat **SAKTËSINË** në shërbimin e ujit.



A E DINI SE ?





Çdo konsumator mund të kërkojë pezullimin e përkohshëm të kontratës në çdo kohë dhe për çdo arsye



Kërkesa duhet të paraqitet me shkrim, të paktën 15 ditë përpara datës së ndërprerjes së kërkuar.



ERRU kujton: Çdo konsumator ka të drejtën të menaxhojë kontratën e vet në mënyrë të ligjshme.



Rr: "Viktor Eftimiu", Ndërtesa 1,
Kati IV, Njësia Administrative
Nr. 5, 1022, Tiranë, Shqipëri



KONTAKT
+355 42 258 046



E- MAIL:
public@erru.al